RAPORT VJETOR
2017

fondiBESA



MISIONI i Fondit BESA është të ndihmojë në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë së vendit duke nxitur zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në Shqipëri, nëpërmjet financimit të tyre me kredi.

Raportin Vjetor 2017 mund ta gjeni edhe në faqen web të Fondit Besa www.fondibesa.com

Për informacione të mëtejshme: Fondi Besa, Rruga "Brigada VIII", Pallati 5, Tiranë, Telefon: +355 42253841/2 Fax: +355 42253836
Email: mfi@besa.org.al Website: www.fondibesa.com

Përmbajtja

MESAZH NGA DREJTORI EKZEKUTIV 4
ZHVILLIMI INSTITUCIONAL 6
IMPAKTI 7
FONDI BESA NË SHIFRA....8
ARRITJE 2017 9
OBJEKTIVAT AFATMESME 10
MENAXHIMI I FONDIT BESA DHE BURIMET NJERËZORE ..11
PËRGJEGJËSIA SOCIALE 13
BILANCI 15
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE....16
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË 17
RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR....19
PROJEKTE 20
STRUKTURA ORGANIZATIVE 22
HISTORI SUKSESI....23
PARTNERËT 27

Mesazhi i Drejtorit Ekzekutiv

E nisëm si mikrokredi për zbutjen e varfërisë për ata që nuk kishin asnjë mundësi të përfitonin një kredi bankare, u zhvilluam dhe rritëm gamën e shërbimeve dhe produkteve dhe tani synojmë zgjerimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtyre shërbimeve në mënyra inovative.

2017: Viti i një progresi të rëndësishëm

Të dashur Aksionarë, Klientë dhe Partnerë,

Viti 2017 shënon një ndër vitet më të suksesshme në arritjen e objektivave të Fondit Besa.

Gjatë vitit 2017, ekonomia dhe sistemi financiar shqiptar u karakterizuan nga tendenca përmirësimi. Ekonomia shqiptare u rrit me 3.9% gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Norma mesatare e inflacionit u rrit në 2.0%, ndërsa norma bazë e interesit ka mbetur e pandryshuar, 1.25%. Aktiviteti i sektorit bankar shfaqet në përmirësim: raporti i kredive me probleme është ulur në 13.2% nga 18.2% në vitin 2016. Punësimi shënoi një rritje mesatare vjetore prej 2.9% gjatë nëntë muajve të parë të vitit, ndërkohë që shkalla e papunësisë zbriti në nivelin 13.6%. Treguesit ekonomikë na japin një tablo pozitive edhe për vitin 2018.

Në një mjedis operativ sfidues, me prezencën e 16 bankave dhe institucioneve mikrofinanciare, Fondi Besa ka arritur të përmbushë objektivat kryesore strategjike, duke i përqendruar përpjekjet në tri prioritete: shërbimi i shkëlqyeshëm ndaj klientëve, përmirësimi i rezultateve financiare dhe pozicionimi më i mirë në treg.

Fondi Besa e kuptoi fuqinë e mikrofinancës që në vitin 1992, kur zbatuam projektin e parë të mikrokredisë me Bankën Botërore dhe Qeverinë Shqiptare. Ky projekt vendosi bazat për një zgjerim gradual, jo vetëm nëpërmjet ofrimit të kredive për të varfërit dhe më pas për bizneset më të strukturuar, por edhe nëpërmjet përpjekjeve për të strukturuar dhe konsoliduar gradualisht aktivitetin mikrofinanciar.

Në vazhdimësi, Fondi Besa, duke adoptuar një strategji agresive rritje, është fokusuar në zgjerimin e aktivitetit në tregjet ekzistuese dhe gjetjen e tregjeve të reja të pambuluara me kredi. Fondi Besa sot ka një shtrirje të gjerë në mbarë vendin, me 75 zyra dhe 498 punonjës.

Gjatë vitit 2017, ne vazhduam përpjekjet për të qenë zgjedhja e parë për 19,989 klientë, nga të cilët 48% klientë të rinj dhe me një volum të disbursuar gjatë vitit në vlerën 7.1 miliardë lekë, rritje me 17.4% në krahasim me vitin 2016.

Gjithashtu, portofoli i kredisë shënon rritje prej 21% në krahasim me vitin 2016, në vlerën 8.47 miliardë lekë. Me një numër në total 30,590 klientë, Fondi Besa renditet ndër institucionet më të mëdhenj mikrofinanciar në vend, çka tregon edhe një herë se suksesi afatgjatë përfundimisht varet nga aftësia për të frymëzuar besimin tek klientët, të cilët shohin tek Fondi Besa partnerin e tyre të përzgjedhur.

Si institucion financiar jo bankar i orientuar drejt klientit, është misioni ynë për të dhënë një kontribut të

rëndësishëm në mbështetjen e klientëve. Rritja e aksesit financiar për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për njerëzit me të ardhura të ulëta, gratë dhe grupet vulnerabël dhe krijimi i vendeve të punës është kritik për një rritje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar ekonomike. Duke u bazuar në parimin e shërbimit cilësor të klientëve, qëllimi ynë është të mbetemi një faktor i rëndësishëm në tregun mikrofinanciar shqiptar dhe një institucion kyç për klientët aktualë dhe potencialë.

Në Fondin Besa, jemi të përkushtuar që të sigurojmë të gjithë partnerët tanë se ne veprojmë me integritet dhe kemi struktura efektive të menaxhimit, si dhe mbajmë një kornizë rigoroze të pajtueshmërisë me rregulloret e brendëshme dhe ato të Bankës së Shqipërisë. Të gjithë punonjësit tanë si dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë të detyruar t'i përmbahen parimeve të "European Code of Good Conduct for Microcredit Providers". Gjatë vitit 2017, Fondi Besa ka nënshkruar angazhimin e tij për të përmbushur kërkesat e Kodit dhe Komisioni Evropian na akordoi Certifikatën e përputhshmërisë me "European Code of Good Conduct for Microcredit Providers".

Si një ndër 50 punëdhënësit më të mëdhenj në Shqipëri për disa vite, unë i jam shumë mirënjohës të gjithë punonjësve për bashkëpunimin e tyre të ngushtë dhe konstruktiv në vitin 2017. Ne mundëm të bënim progres shumë të kënaqshëm në arritjen e objektivave tona ambicioze strategjike, pavarësisht sfidave me të cilat u përballëm.

Gjithashtu, falënderoj sinqerisht stafin menaxhues dhe Këshillin Mbikëqyrës, një grup njerëzish të dedikuar dhe profesionistë, të cilët na mbajnë fort të lidhur me standardet më të larta pasi klientët tanë, aksionarët dhe partnerët meritojnë një institucion, i cili është i besueshëm, dinamik dhe që i përgjigjet interesave të tyre në mënyrën më të mirë të mundshme.

Miqësisht

Prof. Asoc. Dr. Bajram MUÇAJ

Drejtor Ekzekutiv

Zhvillimi institucional



Impakti ynë

MË SHUMË KREDI NË MBËSHTETJE TË BIZNESIT

17.42% më shumë volum kredie i disbursuar se një vit më parë.

MË SHUMË KREDI PËR GRATË NË BIZNES

28% e portofolit të kredisë menaxhohet nga 9,553 kliente femra. Kredia ka mbështetur femrat sipërmarrëse në një integrim më të mirë social në shoqëri nëpërmjet fuqizimit të saj financiar si dhe ka kontribuar për përmirësimin e vetëvlerësimit, vetëbesimit dhe autonomisë së tyre.

MË SHUMË MUNDËSI PËR PUNËSIMIN E GRAVE

46% e stafit total të Fondit Besa janë gra, numri dhe kontributi i të cilave në institucion vjen në rritje nga viti në vit.

RRITJE E BESNIKËRISË SË KLIENTELËS

Ne synojmë të forcojmë pozitat në një treg, ku konkurrenca po bëhet gjithnjë e më e fortë, nëpërmjet ruajtjes së stabilitetit të klientelës bazë, duke rritur nivelin e besnikërisë së tyre, por njëkohësisht duke qenë aktiv në krijimin e marrëdhënieve me klientë të rinj, të cilët do të sigurojnë vazhdimësinë e aktivitetit.

MË SHUMË ZYRA – MË AFËR TREGUT TË SYNUAR

Afërsia me klientelën, fleksibiliteti dhe cilësia e shërbimit janë disa nga veçoritë dalluese të Fondit Besa. Me 75 zyra në të gjithë vendin, ne kemi mundësi më të mirë njohje të tregut dhe përgjigje në kohë të kërkesave të tij.

Fondi BESA në shifra 2017

Asete Totale

10.26 miliardë Lekë

77.19 milion Euro

2016: 8.86 miliardë Lekë

Kapital Total

2.64 miliardë Lekë

19.88 milion Euro

2016: 2.24 miliardë Lekë

Shuma Kumulative

62.26 miliardë Lekë

468.27 milion Euro

2016: 55.2 miliardë Lekë

Klientë Aktivë

30,590

2016: 29,895

Portofoli i Kredisë

8.47 miliardë Lekë

63.73 milion Euro

2016: 7.0 miliardë Lekë

Kthimi mbi Asetet

4.46%

2016: 4.59%

Kredi të dhëna gjatë vitit

19,989

2016: 19,275

Volumi i disbursuar në vit

7.14 miliardë Lekë

53.72 milion Euro

2016: 6.1 miliardë Lekë

Kthimi mbi Kapital

17.40%

2016: 19.77%

Arritje 2017



	2013	2014	2015	2016	2017
Nr. i Kredive Aktive	25,970	28,462	30,028	29,895	30,590
Portofoli i Kredisë ('000,000 lekë)	5,408	5,8378	6,282	7,002	8,473



	2013	2014	2015	2016	2017
Nr. Kredive të Disbursuara	16,549	18,113	19,549	19,275	19,989
Volumi i Disbursuar ('000,000 lekë)	4,736	5,063	5,486	6,082	7,142



	2013	2014	2015	2016	2017
Nr. Kumulativ i Kredive	109,640	127,753	147,302	166,661	186,621
Shuma Kumulative e Disbursuar ('000,000 lekë)	38,363	43,426	48,895	55,156	62,256

Kursi i këmbimit 31. 12. 2017 US$/Lek: 111.10 EUR/Lek: 132.95
Kursi i këmbimit 31. 12. 2016 US$/Lek: 128.17 EUR/Lek: 135.23

Objektivat Afatmesme

Fondi Besa përcakton në mënyrë të qartë strategjitë dhe objektivat afatshkurtra dhe afatmesme për të prioritizuar drejtimin dhe objektivat strategjikë për realizimin e vizionit të tij. Plani afatmesëm është ndërtuar mbi bazë të disa parimeve kryesore, të cilat së bashku sjellin në jetë vizionin për të qenë një institucion mikrofinanciar që është i besueshëm, dinamik dhe që i përgjigjet nevojave të klientelës.
Sigurisht, strategjia afatmesme shpreh ambicien e Fondit Besa për zhvillim për periudhën 2018-2020 dhe synon t'u japë përgjigje proaktive sfidave me të cilat do të përballet; të nxisë maksimizimin e përdorimit efektiv dhe efiçent të burimeve të institucionit si dhe të mjeteve për zbatimin e strategjive dhe arritjen e objektivave.
Realizimi i objektivave qartësisht nuk bazohet vetëm në fondet që ka institucioni në dispozicion, por kryesisht tek burimet njerëzore dhe profesionalizmi i tyre; tek sistemet e informacionit, të cilët sigurojnë përpunimin dhe disponibilitetin e një baze të saktë të të dhënave; si dhe tek kultura e institucionit dhe fryma e bashkëpunimit si një ekip i vetëm për realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Fokusi kryesor në tre vitet e ardhshme do të jetë (2018-2019-2020):

- Disbursimi i rreth 28.2 miliardë lekë gjatë tre viteve të ardhshme,
- Disbursimi i një numri total prej 73,580 kredish,
- Rritja e produktivitetit dhe efiçencës së stafit në të gjitha nivelet,
- Ruajtja e një institucioni financiar të qëndrueshëm dhe efiçent,
- Sigurimi i një aktiviteti të shëndetshëm që krijon besim tek klientët, stafi dhe aksionarët,
- Shtimi i gamës së produkteve të kredisë për t'ju përgjigjur kërkesës,
- Forcimi i kontrollit të brendshëm dhe ruajtja e një cilësie të lartë të portofolit,
- Rritja në vazhdimësi e kapaciteteve të stafit për t'ju përgjigjur ritmeve të rritjes së institucionit,
- Kultivimi i një kulture ku mirëpriten ide inovative dhe zgjidhje kreative,
- Nxitja e inovacionit dhe shkëmbimit të njohurive.

Menaxhimi i Fondit Besa dhe Burimet Njerëzore

Fondi Besa drejtohet nga një strukturë solide menaxhimi, e cila ka siguruar deri tani dhe angazhohet të sigurojë edhe në të ardhmen ruajtjen e themeleve të fuqishme për funksionimin dhe zgjerimin e aktiviteteve kryesore të Institucionit. Vendimet e duhura, të marra në kohën e duhur, në mënyrë efikase dhe inovative nxisin angazhimin dhe produktivitetin e punonjësve dhe kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara në planin afatmesëm të Fondit Besa.

Në fund të vitit 2017, Fondi Besa ka 498 punonjës, krahasuar me 464, në fund të vitit 2016.

Përbërja e Stafit 2017



Suksesi i Fondit Besa do të vazhdojë të varet, ndër të tjera, edhe nga aftësia e institucionit për të mbajtur, motivuar dhe tërhequr punonjës me aftësi dhe eksperiencë, kontributi i të cilëve do ta ndihmojë atë të përballojë sfidat dhe të përfitojë më së shumti nga mundësitë që i ofron tregu.

Departamenti i Burimeve Njerëzore luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e suksesit të ardhshëm të Fondit Besa, i cili udhëhiqet nga vizioni afatgjatë i tij për të punuar në partneritet për të krijuar një mjedis ku punonjësit mund të përparojnë dhe të jenë të aftë për të ofruar një performancë të qëndrueshme organizative.

Performanca e Fondit Besa mbështetet, para së gjithash, tek punonjësit e tij, ndaj një nga objektivat kryesore është forcimi i kapaciteteve të menaxherëve dhe të stafit që të zhvillohen në mënyrë profesionale dhe personale dhe të pozicionojnë organizatën për sukses në të ardhmen. Investimi në aftësitë dhe përshpejtimi i zhvillimit profesional dhe personal synojnë forcimin e aftësive të menaxherëve dhe forcimin e ndjenjës së tyre të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë për t'i mundësuar punonjësve të zhvillohen për të vënë në efiçencë potencialin e tyre të plotë. Në këtë kuadër, Fondi krijoi në 2017 edhe njësinë e trajnimit. Në total janë zhvilluar 22 aktivitete trajnimi me një kohëzgjatje totale prej 44 ditësh dhe kanë përfituar 278 persona.

Një nga aspektet kryesore të punës sonë është aftësimi i punonjësve për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme për të marrë role të reja brenda organizatës, duke mbështetur lëvizjen e brendshme të karrierës, e cila i lejon ata të kenë karrierë më të larmishme dhe plotësuese. Në të njëjtën kohë, Fondi Besa kërkon të pozicionohet si një punëdhënës i zgjedhur: punëdhënës që shpërblen performancën e qëndrueshme dhe ofron një gamë të plotë të përfitimeve për punonjësit.

Fondi Besa i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të strukturave nxitëse dhe shpërblimeve që përforcojnë kulturën e institucionit. Performanca, sjellja në përputhje me vlerat e institucionit dhe kompensimi tashmë janë lidhur më ngushtë se më parë.

Fondi Besa mban në konsideratë edhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet. Në fund të vitit 2017, përqindja e grave në nivel institucioni është 46%, në nivel menaxhimi qendror 30%, menaxherë dege 39% dhe si oficerë kredie 45%.

Fondi Besa është i angazhuar të mbajë standarde të larta etike, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe duke vepruar në një mënyrë shoqërisht të përgjegjshme në kryerjen e veprimtarive të tij. Fondi Besa nuk pranon asnjë formë diskriminimi ose korrupsioni dhe përgjegjësia sociale e kompanisë përfshin komunikim transparent dhe të qartë, aktivitete të përgjegjshme, sjellje etike dhe promovim të barazisë, diversitetit dhe një mjedisi të shëndoshë pune.

Institucion transparent

Fondi Besa është i hapur dhe në nivelin më të lartë të mundshëm të transparencës me palët që bashkëpunon, gjë që nënkupton dhënien e informacionit për veprimtarinë e institucionit palëve të treta (publike), përveçse kur informacioni klasifikohet si i brendshëm dhe konfidencial. Klientët kanë më shumë besim në vlerën e parave të tyre kur e njohin dhe e kuptojnë rolin e Fondit Besa.

Prandaj Fondi Besa është i angazhuar të sigurohet që veprimtaria e tij të komunikohet në mënyrë transparente, qartë, në një gjuhë të thjeshtë, në mënyrë që të kuptohet kështu nga palët e interesuara dhe grupet e synuara. Fondi Besa komunikon me anë të raporteve, prezantimeve, fjalimeve, fletëpalosjeve, konferencave, seminareve dhe publikon raportet e tij vjetore ku përfshihet edhe Raporti i Auditimit të Jashtëm.

Aktivitete të Përgjegjshme në lidhje me mjedisin

Fondi Besa është i përkushtuar të promovojë “zhvillim të shëndoshë dhe të qëndrueshëm mjedisor” në gamën e plotë të aktiviteteve të tij. Jemi të përkushtuar të analizojmë ndikimin që kanë aktivitetet që kryen dhe financon Fondi Besa në mjedis, duke përcaktuar objektivat dhe synimet e duhura për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës sonë mjedisore dhe zbutjen e ndikimit negativ në të. Bazuar në manualet dhe rregulloret e tij, si dhe bazuar në vlerësimet etike, Fondi Besa nuk financon lloje të caktuara të aktiviteteve, duke përfshirë aktivitete që dëmtojnë mjedisin, prodhimin ose tregtinë e armëve dhe municioneve, bizneset e përfshira në prodhimin, përpunimin ose shpërndarjen e drogave ilegale, aktivitetet që shfrytëzojnë punën e fëmijëve, etj.

Etika dhe anti-korrupsioni

Në Fondin Besa jemi veçanërisht të angazhuar që punonjësit të sillen me vetëdijen e nevojshme etike dhe kemi vendosur parime për punonjësit për të promovuar një qëndrim të njëtrajtshëm ndaj çështjeve etike. Fondi Besa vë theks të veçantë në trajnimin e stafit dhe nxitjen e vetëdijes për fushat më të rëndësishme të riskut etik. Punonjësit e rinj janë të trajnuar me qëllim që të zotërojnë rregullat bazë duke u siguruar në këtë mënyrë që ata i njohin dhe i kuptojnë këto rregulla që nga fillimi i punës së tyre. Punonjësit janë të vetëdijshëm se Fondi Besa nuk pranon asnjë lloj diskriminimi apo korrupsioni.

Barazia gjinore

Barazia gjinore është një nga parimet që pasqyron angazhimin e Fondit Besa për respektimin e të drejtave të njeriut dhe praktikimin e tolerancës zero për diskriminim. Në Fondin Besa u jepen të njëjtat mundësi sa i përket promovimit, pagës dhe zhvillimit profesional si femrave ashtu edhe meshkujve.

Sipas politikës së rekrutimit, kandidatët e kualifikuar punësohen pavarësisht nga gjinia, mosha, origjina etnike, besimi politik ose fetar. Në vitin 2017, ndarja gjinore është si më poshtë:

- Punonjësit: 46% femra dhe 54% meshkuj;
- Menaxhimi: 30% femra dhe 70% meshkuj;
- Klientët: 28.4% femra dhe 71.6% meshkuj;

Mjedisi i Punës

Fondi Besa vazhdon të ndjekë në mënyrë sistematike qëllimin për forcimin e reputacionit të institucionit si punëdhënës i preferuar, duke besuar se një reputacion i tillë është vendimtar për arritjen e suksesshme të objektivave të Fondit Besa.

Fondi Besa ka zyra të pajisura mirë. Vendet e punës janë të dizenjuara për të krijuar kushtet më të mira të mundshme për personelin dhe klientët, të cilat janë ndërtuar dhe mirëmbajtur duke përdorur materiale të cilat janë në harmoni me mjedisin.

Ruajtja e Energjisë: Ne synojmë përdorimin efikas të materialeve në dispozicion, monitorimin e rregullt dhe reduktimin e konsumit të energjisë elektrike, ujit dhe përdorimin e karburantit dhe menaxhimin korrekt të mbeturinave (riciklimi ose eliminimi). Në të gjitha ndërtesat e reja, dhe kur rinovohen ndërtesat ekzistuese, kujdes i veçantë i kushtohet shfrytëzimit të dritës natyrore dhe ruajtjes së energjisë.

Politika e Letrës: Është politikë standarde e Fondit Besa të investojë në sistemet kompjuterike dhe të modifikojë procedurat në mënyrë që të shfrytëzohen komunikimet elektronike, brenda dhe jashtë institucionit, me qëllim që të kufizohet në maksimum përdorimi i letrës. Gjithashtu, letrat në zyrë riciklohen.

Bilanci

Shifrat në lekë	2017	2016
AKTIVET		
Mjete monetare dhe ekuivalente	676,133,485	421,067,576
Depozita me afat me bankat	671,996,077	989,486,423
Hua dhënë klientëve	8,186,810,172	6,754,917,859
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	206,566,207	181,378,356
Aktive afatgjata të vlefshme për investim	284,742,420	282,430,982
Investmentime në filiale	57,772,000	66,648,400
Investmentime në shoqëri	81,200,000	60,900,000
Aktive të tjera	96,648,440	106,119,782
Totali i Aktiveve	**10,261,868,801**	**8,862,949,378**
DETYRIMET		
Hua dhe Kredi	5,559,929,995	4,494,311,458
Borxh i varur	1,887,855,066	1,927,896,897
Donacione	13,294,996	54,063,597
Tatim fitimi i pagueshëm	10,481,901	29,481,933
Detyrime të tjera	147,120,464	119,090,833
Totali i Detyrimeve	**7,618,682,422**	**6,624,844,718**
KAPITALI		
Kapitali Aksionar	2,151,191,000	1,768,661,000
Rezerva ligjore	86,913,660	66,780,411
Fitime të mbartura	405,081,719	402,663,249
Totali i Kapitalit	**2,643,186,379**	**2,238,104,660**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	**10,261,868,801**	**8,862,949,378**

Kursi i këmbimit 31. 12. 2017 US$/Lek: 111.10 EUR/Lek: 132.95

Kursi i Këmbimit 31. 12. 2016 US$/Lek: 128.17 EUR/Lek: 135.23

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Shifrat në lekë	2017	2016
Interesa		
Të ardhura nga Interesat	1,829,624,272	1,653,011,552
Shpenzime për Interesat	-351,320,200	-322,855,490
Të Ardhura Neto nga Interesat	**1,478,304,072**	**1,330,156,062**
Të Ardhura të Tjera		
Të ardhura nga Donacionet	55,634,051	5,994,706
Të ardhura të tjera, neto	164,893,024	147,973,238
Totali i të Ardhurave të Tjera	**220,527,075**	**153,967,944**
Shpenzime Operative		
Humbja nga zhvlerësimi i kredive për klientët	-160,849,360	-87,167,656
Shpenzime personeli	-645,697,910	-610,772,117
Shpenzime të tjera administrative	-343,342,742	-267,258,141
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	-58,299,829	-39,153,162
Humbje neto nga lëvizjet në kursin e këmbimit	-4,750,975	-813,208
Totali i Shpenzimeve Operative	**-1,212,940,816**	**-1,005,164,284**
Fitimi para Tatimit	**485,890,331**	**478,959,722**
Shpenzime për Tatimin mbi Fitimin	-80,808,612	-76,296,473
Fitimi neto i periudhës	**405,081,719**	**402,663,249**
Të ardhura të tjera neto nga tatimi mbi fitimin	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse	**405,081,719**	**402,663,249**

Kursi i këmbimit 31.12.2017 US$/Lek: 111.10 EUR/Lek: 132.95

Kursi i Këmbimit 31.12.2016 US$/Lek: 128.17 EUR/Lek: 135.23

Pasqyra e flukseve të parasë

Shifrat në lekë	**2017**	**2016**
Flukset e arkës nga aktivitete operative		
Fitimi neto i periudhës	405,081,719	402,663,249
Korrigjime për:		
Zhvlerësimin dhe Amortizimin	58,587,205	39,153,162
Nxjerrje jashtë përdorimit e aktiveve	10,971,755	-
(Fitim)/humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve	8,527,538	-7,318,322
Humbjet nga zhvlerësimi i huave për klientët	160,849,360	87,167,656
Amortizimi i granteve	-55,634,051	-5,994,706
Diferenca të kursit të këmbimit nga rivlerësimi i granteve	1,570,450	813,208
Hua të fshira	132,836,126	16,021,755
Të ardhura nga interesat	-1,829,624,272	-1,653,011,552
Shpenzime për interesat	351,320,200	322,855,490
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	80,465,073	76,296,473
Ndryshime në:		
Hua për klientët	-1,668,113,336	-775,558,117
Investime në aktive	-11,423,600	
Aktive të tjera	9,471,342	-36,092,253
Detyrime të tjera	28,029,631	-11,884,266
Interesi i arkëtuar	1,772,159,809	1,672,987,743
Interesi i paguar	-371,551,967	-343,103,931
Tatimi mbi fitimin i paguar	-99,465,105	-64,472,551
Flukse të arkës nga aktivitetet operative, neto	**-1,015,942,123**	**-279,476,962**

Kursi i këmbimit 31. 12. 2017 US$/Lek: 111.10 EUR/Lek: 132.95

Kursi i Këmbimit 31. 12. 2016 US$/Lek: 128.17 EUR/Lek: 135.23

Pasqyra e flukseve të parasë

Shifrat në lekë	**2017**	**2016**
Flukset e arkës nga aktivitetet investuese		
Blerje e aktiveve afatgjata	-86,277,438	-144,501,799
Blerje e aktiveve afatgjata të vlefshme për investim	-25,170,894	-68,320,876
Rritje në depozitat me afat në banka	317,490,346	782,619,885
Investime në shoqëritë e lidhura	-	-73,548,400
Të ardhura nga shitja e aktiveve fikse	5,862,545	48,115,359
Flukset e arkës të përdorura në aktivitetet investuese	**211,904,559**	**544,364,169**
Flukset e arkës nga aktivitetet financuese		
Të ardhura nga huatë dhe detyrimet e varura, neto	1,045,808,473	-229,364,032
Të ardhura nga grantet	13,295,000	-
Flukset e arkës gjeneruar nga aktivitetet financuese	**1,059,103,473**	**-229,364,032**
Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente	255,065,909	35,523,175
Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të vitit	421,067,576	385,544,401
Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të vitit	**676,133,485**	**421,067,576**

Kursi i këmbimit 31. 12. 2017 US$/Lek: 111.10 EUR/Lek: 132.95

Kursi i Këmbimit 31. 12. 2016 US$/Lek: 128.17 EUR/Lek: 135.23

Raporti i auditorëve të pavarur

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit,
Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji- Miniera
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

Deloitte.

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Fondi BESA Sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondi BESA Sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë audituar nga një tjetër auditues i certifikuar i cili ka lëshuar një opinion të pakualifikuar mbi ato pasqyra financiare më 1 qershor 2017.

Baza e Opinionit

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqërisa në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see http://www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

©2018 Deloitte Audit Albania

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheçim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji - Miniera,
Tirana, Shqipëri
Numër identifikimi unik i subjektit (NUIS): L41709002H

DELOITTE AUDIT ALBANIA
Tel 0445917920
NIPT: L41709002H TIRANA - ALBANIA

Elvis Zia
Audituesi Ligjor
Partner Angazhimi

Tiranë, Shqipëri
25 qershor 2018

“Bukë, Kripë e Zemër – Ushqimi, Tradita dhe Kultura: Procese të Bashkë-zhvillimit të Zonave të Margjinalizuara të Veriut dhe Jugut të Shqipërisë” është projekti i bashkë-financuar nga AICS-MAECI (Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim), i zbatuar nga OJQ-të VIS Albania e Cesvi Albania, në partneritet me Bashkinë Malësi e Madhe dhe Bashkinë Përmet, në bashkëpunim me Fondin BESA sh.a dhe Fondacionin PfD. Ky projekt, i cili një komponent të rëndësishëm kishte mikrokredinë, u finalizua më 31 Maj 2017 dhe synonte zhvillimin e skemave inovative të kredidhënies për përmirësimin e jetës së familjeve rurale dhe promovimin e bizneseve fillestare në qarkun e Shkodrës dhe rrethin e Përmetit.

Impakti i këtij projekti si dhe projektit të mëparshëm që kemi implementuar në këtë zonë ka qenë kompleks, jo vetëm në fuqizimin ekonomik nëpërmjet mbështetjes së zhvillimit të biznesit të vogël, por gjithashtu në edukimin financiar dhe përfshirjen sociale të klientëve, përmirësimin e cilësisë së jetës, arsimimin e fëmijëve, etj.

“Shqipëri, Udhëto në Mënyrën Tënde: Menaxhimi Multi-aktor i Integruar i Turizmit Rural dhe Kulturor në Qarqet Gjirokastër dhe Berat (TREC) në bashkitë Gjirokastër, Përmet, Berat e Skrapar. Në Tetor 2017, Fondi BESA nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Fondacionin CESVI për implementimin e projektit. Objektivi i Projektit është të zhvillojë një sistem të integruar dhe të fuqizuar të pritjes turistike: kjo nënkupton krijimin e Partneriteteve Publike-Private për menaxhimin e produkteve dhe shërbimeve të njohura nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, Ministria e Turizmit dhe e Ambientit, rritjen e volumit të aktivitetit të SME-ve, rritjen e numrit të turistëve të regjistruar në nivel lokal.

Projekti BERZH – AASF (Janar 2017 – Janar 2020) filloi të implementohet në Janar 2017 në përputhje me marrëveshjen e kredisë dhe të bashkëpunimit për Programin për Mbështetjen e Agrobiznesit në Shqipëri të nënshkruar ndërmjet Fondit BESA dhe BERZH-it. Qëllimi i këtij projekti të iniciuar nga BERZH në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare është promovimi dhe rritja e aksesit për financimin e agrobiznesit në Shqipëri. Ky projekt përbëhet nga tre komponentë të lidhur me njeri-tjetrin:

- Kredia
- Asistenca teknike
- Skema e garancisë e mbështetur në fondet "grant", të cilat do të akordohen nga Qeveria Shqiptare.

Në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit, ka filluar implementimi i programit për ngritjen e kapaciteteve, në kuadër të të cilit janë organizuar trajnime me fokus marketingun dhe shitjen e kredisë bujqësore në degët pilot të përfshira në këtë projekt: Korçë, Lushnjë, Fier dhe Shkodër.

Projekti EaSI (Skema e garancisë për Punësim dhe Inovacion Social) është një instrument financiar i mundësuar nga BE për të promovuar punësim të qëndrueshëm, për të garantuar mbrojtjen e duhur sociale, për të luftuar përjashtimin social dhe varfërinë dhe përmirësimin e kushteve të punës. Në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Fondit BESA dhe Fondit Evropian për Investime kjo skemë garancie mbulon një pjesë të riskut për dy produkte të veçanta për bujqësinë dhe rininë si dhe investime për ngritjen e kapaciteteve.

Struktura Organizative



STRUKTURA DEGËVE



Histori suksesi

"Në vitin 2007 fillova të punoj pranë një studio fotografike për të ndihmuar fotografin të stamponte fotot. Në atë kohë, kurrë nuk kam menduar se fotografia do të ishte pasioni im i fortë. Shpejt, kuptova se nuk ishte vetëm një pasion, një hobi, por po kthehej në profesionin tim ".

Nertila pranon se gjatë gjithë jetës së saj ajo ka qenë krijuese. Duke e kuptuar këtë, ajo filloi të mendonte seriozisht për atë që donte të bënte me jetën e saj dhe energjinë krijuese, dhe në vend që të qëndronte përpara një kompjuteri në stampimin e fotografive, vendosi që të përpiqej të bënte karrierë në fotografim, duke përdorur aftësitë që kishte ushtruar duke fotografuar miqtë e saj vetëm për argëtim.

"Unë guxova të hap studion time fotografike. Kam dëgjuar se Fondi Besa është shumë i shpejtë në dhënien e kredive, kështu që takova Entelën, oficeren e kredisë, e cila ishte një ndihmë e madhe. Kisha nevojë të blija një aparat të mirë fotografik dhe disa pajisje të tjera për studion. Isha e lumtur dhe pak e frikësuar në të njëjtën kohë. Kur kam marrë aparatin e parë profesional në dorë, ishte sikur të kisha një fëmijë të sapolindur. Nuk e kisha kuptuar kurrë se sa avantazhe mund të ofrojë një aparat fotografik profesional, nëse ke imagjinatë dhe dëshirë për të mësuar. Për këtë arsye, para se të hapja studion, mora pjesë në një kurs për fotografët profesionistë. Kam filluar të pasuroj njohuritë e mia fotografike dhe të kuptoj më mirë kamerën dhe ky ishte fillimi i suksesit tim ".

Duke pranuar se nuk kishte klientë, nuk kishte përvojën e duhur dhe nuk kishte idenë se si të menaxhonte një biznes të vërtetë, Nertila e kuptoi

se dëshpërimi ishte një motivues i madh. Ajo filloi të punojë shumë duke testuar me shkrepje të shumta, teste në photoshop, duke fotografuar familjen dhe miqtë e saj, derisa filloi të krijonte besimin në atë që po bënte.

"Çdo fotografi që bëj - thotë Nertila - tregon një histori. Është një punë që të jep kënaqësi dhe emocione. Unë përpiqem të transformoj fotografitë e zakonshme në pjesëza arti. Shumë njerëz festojnë ditëlindje, martesa, jubile, ardhjen e një fëmije në jetë dhe duan të fiksojnë momentet më të lumtura të jetës së tyre në foto. Këto janë kujtime që ata do të vazhdojnë t'i ruajnë nga brezi në brez.

Suksesi e bëri Nertilën të mendojë për blerjen e disa pajisjeve të tjera profesionale, të cilat ishin vërtetë të shtrenjta, kështu që i duhej të mendonte edhe për një kredi të dytë. Kredia e dytë ishte më e lehtë për të.

"Tani nuk kam më frikë të marr kredi. Kur do të punosh, je në gjendje të paguash edhe kredinë në kohë. Me të vërtetë kredia më ndihmoi shumë. "

Tani Nertila ka punësuar një asistente, e cila e ndihmon në biznes. Por Nertila përmend se në të vërtetë nuk është kaq e lehtë të kesh sukses në këtë lloj biznesi, për shkak se kamerat dixhitale, të cilat vazhdimisht po përmirësohen dhe sofistikohen, po bëhen më të përballueshme për t'u blerë dhe më të lehta për t'u përdorur. Tani që kamerat janë të integruara në smartphones dhe pajisje të tjera të lëvizshme mund të themi se praktikisht çdo njeri ka një aparat fotografik në dorë. Por është syri për të kapur këndin e duhur, dritën e duhur, si dhe momentin e duhur që e bën atë moment të paharrueshëm.

Rabushja, rreth 50 vjeç, shkëlqen nga krenaria kur na tregon serat, në fshatin më të afërt në Lushnje.

"Së bashku me burrin kemi filluar të punojmë me sera në tokën që kishim në fshatin tonë - thotë ajo. Por më besoni, menduam se do të ishte më mirë për ne dhe për fëmijët tanë të emigronim në Greqi. Ishte e vështirë për të shitur perimet në qytet, sepse nuk kishte rrugë dhe nuk kishim një kamion tonin. Fëmijët ishin ende të rinj dhe jeta nuk ishte e lehtë. Vendosëm të emigronim në Greqi, kështu që lamë gjithçka që kishim ndërtuar këtu.

Kemi punuar në sera në Greqi për disa vite, por në ëndrrat tona ktheheshim çdo ditë në shtëpinë tonë të vogël në Shqipëri, mbillnim serat tona, të rrethuar nga miqtë dhe të afërmit. Na merrte malli për bisedat mbrëmjeve me fqinjët tanë, jashtë deri vonë, nën pemët e oborrit, për qeshjet tona dhe zhurmat e fëmijëve që luanin në oborrin e gjelbëruar.

Fëmijët po rriteshin dhe me dëshirën për të mbajtur familjen së bashku, me një përvojë të pasur dhe motivim më të fortë vendosëm të ktheheshim dhe të investonim kursimet tona këtu. Por kursimet nuk ishin të mjaftueshme për të filluar një serë prej 3.5 dynym, ndaj filluam të pyesnim se ku mund të

merrnim një kredi. Kështu kontaktuam Inën, oficeren e kredisë në Fondin Besa, e cila na ndihmoi shumë. Morëm kredinë e parë në kohën e duhur dhe përsëri kohët e fundit kemi marrë një kredi tjetër prej 1 milion lekësh. Dimri i kaluar na frikësoi shumë. Ishte parashikuar borë, kështu që na duhej të vepronim menjëherë, duke mbuluar serën me një shtresë të dytë të plastikës për të mbrojtur të mbjellat.

Kërkuam kredi dhe ishte Fondi Besa që iu përgjigjej menjëherë kërkesës sonë. Oficerja e kredisë erdhi për të parë serën dhe brenda një kohe shumë të shkurtër morëm kredi, çka na ndihmoi të përfundonim mbulimin para fillimit të ngricave.

E kënaqur që biznesi shkon mirë dhe e lumtur se e gjithë familja punon së bashku bashkëshorti, djemtë dhe bashkëshortet e tyre, Rabushe thotë se tashmë ata marrin edhe punëtorë sezonalë gjatë kulmit të prodhimit.

"Megjithëse është një punë e vështirë, ende kam ndërmend të punësoj më shumë vajza në biznesin tim - thotë ajo."

Rabushe është shumë e ndjeshme kur bëhet fjalë për punësimin e vajzave, ndoshta edhe për shkak se vetë është rritur duke punuar shumë dhe në kushte të vështira. Ajo dëshiron të jetë një model për t'u treguar vajzave se çfarë është e mundur të arrijnë kur marrin një arsim të mirë dhe punojnë shumë.

Suksesi në biznes ka bërë që Rabushja të vlerësojë ndryshe veten dhe qëndrimin e saj në komunitetin ku jeton. Ajo ndihet më e sigurt tani dhe më e përfshirë në aktivitete të ndryshme në komunitet.

Këshilla e saj për gratë e tjera që duan të jenë të suksesshme është të punojnë shumë dhe të mos ndjehen për asnjë moment keq për punën që bëjnë. "Jemi ne që e bëjmë jetën tonë", thotë ajo. "Suksesi është në duart tona".

Partneret

BIB
FAIR BANKING

CoopEst
finance for social economy initiatives in central eastern europe

Frankfurt School
of Finance & Management
German Excellence. Global Relevance.

ALBANIAN BESA CAPITAL
Fondacioni ABC

Raiffeisen BANK

BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

SOCIETE GENERALE ALBANIA

TIRANA BANK

Fondi BESA sh.a.
Rruga: “Brigada VIII”, Pallati Nr. 5
(zona e ish-Bllokut), Tiranë - Shqipëri
Tel: 04 2253841/2 Fax: 04 2253836
E-mail: mfi@besa.org.al www.fondibesa.com